



Republika e Kosovës
Republika Kosovo • Republic of Kosovo

Institucion i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 567/2019

Nr./fq/Br./str./Nr./pg.
08/04/2019

Datum/Date: 08/04/2019

PRISHTINË PRISTINA-PRISTINA



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

MENDIM JURIDIK I AVOKATIT TË POPULLIT I REPUBLIKËS SË
KOSOVËS NË CILËSINË E MIKUT TË GJYKATËS (AMICUS
CURIAE) PËR GJYKATËN KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS

A.nr. 291/2019
Ankesa e avokatëve Tomë Gashi dhe Mexhid Syla
Ex Officio. nr. 927/2018

në lidhje me

Rastin e z. Sylejman Selimit, z. Nexhat Demakut dhe të tjera e në Gjykatën Kushtetuese ndaj Aktgjykimit Pml.nr.158/2018, i Gjykatës Supreme të Kosovës, datë 26.9.2018, duke u bazuar në zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatëse Kushtetuese nr. AGJ 1248/18, i datës 7 qershor 2018

Për: Znj. Arta Rama, kryetare e Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Prishtinë, më 8 prill 2019

I. Qëllimi

- Avokati i Popullit, në zbatim të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, përmes këtij Mendimi Juridik (*Amicus Curiae*), ka për qëllim të ofrojë ndihmën juridike në funksion të mbrojtjes së të drejtave të ankuesve në procedurë penale. Konkretisht, ky Mendim Juridik ka të bëjë me të drejtën e ankuesve që lënda e tyre të kthehet në rigjykim në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, siç është vendosur për rastin e z. Selimit nga Gjykata Supreme e Kosovës me **Aktgjykimin PLM.KZZ.nr.223/2017, i datës 11 qershor 2018** (në tekstin e mëtejmë: Aktgjykimi PLM.KZZ.nr.223/2017 i GjS i dt. 11 qershor 2018). Kjo përfaktin se e drejta proceduralë për kthimin e lëndës në rigjykim, sipas aktgjykimit të lartpërmendur, është mohuar me aktgjykimin tjetër të Gjykatës Supreme, përkatesisht **Aktgjykimin Pml.nr.158/2018, datë 26.9.2018** (në tekstin e mëtejmë: Aktgjykimi Pml.nr.158/2018 i GjS dt.26 shtator 2018). Në vijim e drejta që lënda të kthehet në rigjykim, siç ka vendosur Gjykata Supreme me Aktgjykimi PLM.KZZ.nr.223/2017 i GjS i dt.11 qershor 2018, do të analizohet në pajtim me Kushtetutën, me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale (në tekstin e mëtejmë: KPP), me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNj) dhe me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GjEDNj).

II. Baza juridike

- Ky Mendim Juridik (*Amicus Curiae*) i Avokatit të Popullit bazohet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), ku sipas nenit 132, paragrafi 1: “*Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.*”; dhe në Ligjin nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, nenin 16, paragrafi 9, ku përcaktohet: “*Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimit.*”

III. Përbledhja e fakteve

- Institucioni i Avokatit të Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1 të Ligjit për Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 4 prill 2019, ka pranuar ankesën e z.Nexhat Demaku dhe të tjera kundër Aktgjykimit te Gjykatës Supreme të Kosovës PML 158/2018, i dt.26 shtator 2018 lidhur me zbatimin e Aktgjykimit e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës nr.1248-18 të dt.7 qershor 2018. Ankuesi kërkon nga Avokati i Popullit që të jepë një mendim në cilësinë e Amicus Curiae për rastin e tyre, i cili është duke u trajtuar ne Gjykatën Kushtetuese për here te dyte.

Po ashtu, Avokati i Popullit, ka vendosur te hape hetime sipas detyrës zyrtare “Ex officio”, lidhur kërkesën publike nga seanca plenare e Parlamentit te Kosovës, për vizitë te paraburgosurit/dënuarit z. Sylejman Selimi, ne Burgun e Dubravës.

Ne seancën plenare te Kuvendit te Republikës se Kosovës, e mbajtur me 2 nëntor 2018, deputeti z. Daut Haradinaj i ka bërë thirrje publike Avokatit te Popullit, që ta vizitojë z.Sylejman Selimin, në burgun e Dubravës, dhe ta trajtojë rastin e tij.

Gjithashtu, Avokati i Popullit, më 31 qershor 2018 ka pranuar ankesën e avokatëve mbrojtës z. Tomë Gashi dhe z. Mexhid Syla si përfaqësues të z. Sylejman Selimit dhe z. Jahir Demaku, lidhur me mbajtjen në paraburgim/vuajtje të dënimit pa vendim gjyqësorë të z. Sylejman Selimit dhe z. Jahir Demaku.

4. Më 11 qershor 2018, Gjykata Supreme e Kosovës, Aktgjykimi PLM.KZZ.nr.223/2017, duke shqyrtaur Kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i z. Sylejman Selimit, ka anuluar aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kosovës PA II 11/2016, datë 3 korrik 2017, Aktgjykimin PAKR nr. 455/15 të Gjykatës se Apelit, datë 15 shtator 2016 dhe Aktgjykimin P.nr. 938/13 të Gjykatës Themelore ne Mitrovicë (në tekstin e mëtejshmë: Aktgjykimi i Gjykatës Themelore), datë 27 maj 2015, duke aprovuar pjesërisht si të mirë bazuar, në pjesën që ka të bëjë me përbërjen e trupit gjykuar të Gjykatës Themelore, duke vendos që lënda të kthehet në rigjykim në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.
5. Me aktgjykimin e lartpërmendur, Gjykata Supreme nuk i ka trajtuar meritat e rastit në lidhje me fajësinë apo pafajësinë e z. Selimit, i cili ishte shpallur fajtor nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, që pastaj është konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit (*Aktgjykimi PAKR nr. 455/15 i datës 15 shtator të vitit 2016*) dhe nga Gjykata Supreme (*Aktgjykimi PA II 11/2016 i datës 3 korrik 2017*), duke e shpallur fajtor dhe duke e dënuar me 8 vjet burgim.¹ Gjithashtu, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin e dt.11 qershor 2018, nuk kishte marrë vendim as në lidhje me lirimin apo mbajtjen në paraburgim të z. Selimit, por vetëm ka konstatuar shkeljen në lidhje me përbërjen e trupit gjykuar.
6. Më 7 qershor 2018, Gjykata Kushtetuese ka nxjerrë Aktgjykimin nr. AGJ 1248/18, duke vendosur sipas kërkesave për vlerësimin e kushtetutshmërisë së “*Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. KZZ.nr. 322/2016, të 19 korrikut 2017*”, i parashtruara nga ankuesit I. Th., Z. D., F. D., N. D., J. D., S. D., D. D., B.D. dhe A. D. Në aktgjykimin e saj, Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se ka pasur shkelje “*të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe paragrafit 1, të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*”, për shkak të mungesës së arsyetimit të përbërjes së trupit gjykuar, dhe e ka shpallur të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Pml.nr.322/2016, të 19 korrikut 2017, dhe çështjen e ka kthyer për rishqyrtim në Gjykatën Supreme. *Në lidhje me këtë çështje, z. Selimi apo mbrojtësi i tij, nuk kanë parashtruar asnje kërkesë për Gjykatën Kushtetuese në lidhje me çështjen penale kundër tij.*
7. Më 26 shtator 2018, në zbatim të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata Supreme ka marrë Aktgjykimin Pml.nr.158/2018, datë 26.9.2018, me të cilin ka refuzuar kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë për ankuesit I. Th., Z. D., F. D., N. D., J. D., S. D., D. D., B. D. dhe A. D. (të cilët edhe kanë parashtruar kërkesa në Gjykatën

¹ Në pajtim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore të tij, Avokati i Popullit nuk do t'i trajtojë aspektet që lidhen me vendosjen meritore të çështjes penale ndaj z. Selimit, përkatësisht fajësinë apo pafajësinë e tij, por Mendimi Juridik do të fokusohet në aspektin procedural që përkon me të drejtat themelore të garantuar me Kushtetutë, me ligj dhe me KEDNJ. Në pajtim me këtë, edhe aktgjykimet e gjykatave të rregullta dhe të Gjykatës Kushtetuese do të theksohen vetëm për aq sa është e nevojshme të analizohen garancitë për të drejtat e njeriut në procedurë penale, në këtë rast për z. Selimin.

Kushtetuese, siç u sqarua me lart). Me këtë aktgjykim, Gjykata Supreme ka vendosur edhe për refuzimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të z. Selimi, **edhe pse për të njëjtën kishte vendosur një herë, përkatësisht me Aktgjykimin e GjS të dt. 11 qershor 2018**, me të cilin ishte aprovuar pjesërisht kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, në pjesën që ka të bëjë me **përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës Themelore, ku ishte vendosur që lënda t'i kthehet Gjykatës Themelore në Mitrovicë për rigjykim**. Me këtë aktgjykim, z. Selimit i mohohet e drejta që lënda e tij të kthehet në rigjykim.

IV. Analiza e rastit

8. Analiza dhe trajtimi i rastit të ankuesve ka si pikënisje mospërfilljen e duhur të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. ref 1248/18, datë 7 qershor 2018, nga Gjykata Supreme e Kosovës, sa u përket pretendimeve në lidhje me përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës Themelore.
9. Po ashtu, Gjykata Supreme, në Aktgjykimin PML. KZZ nr. 223/2017, për një rast të ngjashëm – i njëjtë me rastin në fjalë, kishte aprovuar pjesërisht kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë në pjesën që ka të bëjë me pretendimet për përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës Themelore dhe lëndën e kishte kthyer për rigjykim në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.
10. Mbi këtë bazë, Avokati i Popullit rikujton se një e drejtë e fituar në procedurë penale, që nga aspekti procedural nënkupton rigjykimin e çështjes penale nga Gjykata Themelore e Mitrovicës, për shkak të kontestimit të përbërjes së trupit gjykues, siç është aprovuar nga Gjykata Supreme, do duhej të përdorej si praktikë për rastet identike.
11. Në lidhje me këtë, Avokati i Popullit rikujton se është parim themelor i drejtësisë kur me rastin e paraqitjes së ankesës së cilitdo të akuzuar, Gjykata (...) çmon se arsyet për të cilat ka marrë vendim në dobi të të akuzuarit, e që nuk janë të natyrës personale, shkojnë në dobi edhe të ndonjërit nga të bashkakuzuarit, i cili nuk ka paraqitur ankesë ose nuk e ka paraqitur në atë drejtim (...) (KPP, neni 397 Beneficium Cohesionis), e që në rastin konkret GjS-ja nuk e ka përfillur këtë parim, sepse nuk i ka marrë parasysh konstatimet e saj sipas Aktgjykimit PLM.KZZ.nr.223/2017 të GjS të dt. 11 qershor 2018.
12. Siç u theksua me lart, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. ref 1248/18, datë 7 qershor 2018, qartë ka konstatuar se me këtë shkelet neni **31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**, paragrafit 1, i Kushtetutës, ku ndër të tjera parashihet: “*Çdokujt i garantohet mbrojje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykavave...*”; dhe neni **6** i KEDNj-së, ku përveç tjerash, në paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet si garanci: “*Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme...*”. Gjithashtu edhe paragrafi 2 i nenit 31 të Kushtetutës parasheh **parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë** në trajtimin e çështjeve nga gjykatat, ku ndër të tjera, përcaktohet: “*Çdokush gjëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm (...) për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër*

saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme...”

13. Nga kjo del se konstatimi i Gjykatës Kushtetuese për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], paragrafit 1, i Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNj-së në lidhje me përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, konfirmon edhe Aktgjykimin PLM.KZZ.nr.223/2017 të GjS të dt. 11 qershor 2018, me të cilin **është vendosur që lënda t'i kthehet Gjykatës Themelore në Mitrovicë për rigjykim.**
14. Gjykata Supreme, në zbatim të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, me Aktgjykimin Pml.nr.158/2018, i datës 26.9.2018, i ka refuzuar kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë për ankuesit I. Th., Z. D., F. D., N. D., J. D., S. D., D. D., B. D. dhe A. D., ka përfshirë edhe z. Selimin, duke ia mohuar mundësinë që lënda kundër tij të kthehet në rigjykim, siç kishte vendosur vetë kjo gjykatë me aktgjykimin paraprak dhe për të njëjtën çështje.
15. Nga kjo që u tha me lart, del se Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Pml.nr.158/2018, i datës 26.9.2018, përveçse ka vendosur në kundërshtim me praktikën dhe aktgjykimin e saj për të njëjtën çështje, me këtë aktgjykim **është shkelur e drejta e z. Selimit, I. Th., Z. D., F. D., N. D., J. D., S. D., D. D., B. D. dhe A. D., që të mos keqësohet pozita e tij në procedurë penale.** Mbi këtë bazë, Avokati i Popullit konsideron se ky aktgjykim, sa i takon pjesës për z. Selimin, **është në kundërshtim edhe me dispozitat e KPP-së (në lidhje me shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale) dhe cenon parimin e gjykimit të drejtë dhe të paanshëm,** që garantohet me Kushtetutë (neni 31), me nenin 6 të KEDNj-së (që u theksuan me lart), si dhe **është në kundërshtim me standarde ndërtuara nga jurisprudanca GjEDNj-së.**
16. Sa u takon dispozitave të **KPP-së**, Kolegji i Gjykatës Supreme, me Aktgjykimin Pml.nr.158/2018, dt. 26.9.2018, nuk ka zbatuar drejt kompetencat e saj në lidhje me trajtimin e rastit të z. Selimit dhe ankuesve të tjerë nga aspekti procedural, duke mos e kthyer në gjykatën e shkallës së parë, për shkak të kontestimit të përbërjes së trupit gjykues. Këtë vlerësim Avokati i Popullit e mbështet në dispozitat e KPP-së që përcaktojnë kompetencat e Gjykatës Supreme në procedurën ankimore dhe arsyet kur çështja penale duhet të kthehet ne rigjykim.
17. Fillimisht duhet theksuar se KPP-ja, në nenin 407, paragrafi 2 përcakton: “**Nenet 389 deri 406 të këtij Kodi zbatohen përshtatshmërisht për procedurën ankimore para Gjykatës Supreme**”, që nënkupton se dispozitat në fjalë, të cilat parashihen për procedurën që e zhvillon Gjykata e Apelit, mund të zbatohen edhe nga ana e Gjykatës Supreme. Ndërsa në lidhje me këtë dispozitë, në nenin 402, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, baza për të kthyer çështjen në rigjykim, përveç tjerash parashihet në rastet: “**Ekziston shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, dhe Gjykata e Apelit nuk mund të procedojë sipas nenit 403 të këtij Kodi**;²³ Ndërsa, sipas nenit 384,

² Sipas nenit 403, parag.1 që i referohet mundësisë së ndryshimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës me të ulët (gjykatës themelore), këtë mundësi e parashevë në rastet kur “*është konstatuar vërtetimi i gabuar apo jo të plotë të fakteve (nënparg.1.1.) dhe mund të vërtetojë dhe të çmojë provat materiale pa mbajtur shqyrtim, nëse nuk ka nevojë për të marrë prova të reja apo për të përsëritur shqyrtimin e provave (nënparg.1.2.)*”. Ky aspekt nuk është kontestuar as nga Gjykata Supreme me Aktgjykimin e datës 11 qershor 2018 dhe as nga Gjykata Kushtetuese, por vetëm përbërja e trupit gjykues të Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

paragrafi 1, ndër të tjera, si shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, konsiderohet: “*1.1. Përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin ose kur në marrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, ose kur me vendim të formës së prerë është përjashtuar nga gjykimi; 1.2. në shqyrtim gjyqësor ka marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur të përjashtohet.*”

18. Në pajtim me këto dispozita të KPP-së, del se lënda e z. Selimit është dashur të kthehet në rigjykim në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, për shkak të kontestimit të përbërjes së trupit gjykues (siç është vendosur me Aktgjykimin PLM.KZZ.nr.223/2017 të GjS të dt. 11 qershori 2018 dhe është konfirmuar edhe nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese). Mbi këtë bazë, Avokati i Popullit rithekson se Aktgjykimin Pml.nr.158/2018 i GjS i datës 26.9.2018, në raport me lëndën e z. Selimit është në kundërshtim **me parimin e gjykimit të drejtë dhe të paanshëm** dhe si i tillë, **ndikon edhe në uljen e besimit të qytetarëve në gjykatë, përkatësisht në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës.**
19. Duke rikujtuar nenin 53 të Kushtetutës [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] ku përcaktohet: “*Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*”, Avokati i Popullit thekson se Aktgjykimin Pml.nr.158/2018 i GjS i datës 26.9.2018, në raport me çështjen penale kundër z. Selimit dhe I. Th., Z. D., F. D., N. D., J. D., S. D., D. D., B. D. dhe A. D., është në kundërshtim edhe me praktikën e GjEDNj-së.
20. Në këtë drejtim, GjEDNj-ja, duke u referuar në nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNj-së, në praktikën e saj ka sqaruar edhe standardin në lidhje me parimin e paanshmërisë dhe nevojën e nxitjes së besimit të qytetarëve në gjykata. Kështu në çështjen *Piersack kundër Belgjikës* (1 tetor 1982, parag. 30) në lidhje me paanshmërinë e gjyqtarit në gjykimin e çështjes, ndër të tjera, ka theksuar: “*Paanshmëria nënkuption mungesën e paragjykimeve ose anshmërisë, dhe se ekzistenca e saj ose mos ekzistenca në mënyrë të dukshme në bazë të Nenit 6 (1) të Konventës mund të testohet në mënyra të ndryshme...që nga ana objektive nënkuption përcaktimin nëse ai ofron garanci të mjaftueshme për të përjashtuar ndonjë dyshim legjitim në këtë kuadër.*” (parag. 30); dhe gjithashtu Gjykata ka bërë të qartë: “*Cilido gjyqtar në lidhje me të cilin ekziston një arsyesh legjitime për të pasur frikë se i mungon paanshmëria duhet të tërhiqet.*” (parag. 48).
21. Në lidhje me këtë përcaktim, Avokati i Popullit thekson se, në raport me rastin e z. Selimit, moskthimi i çështjes në rigjykim në Gjykatën Themelore dhe mosaplikimi i kësaj praktike në rastin I. Th., Z. D., F. D., N. D., J. D., S. D., D. D., B. D. dhe A. D., përbën shkelje të standardit të paanshmërisë. Ky konstatim del duke u bazuar në Aktgjykimin PLM.KZZ.nr.223/2017 të GjS të dt. 11 qershori 2018, me të cilin është aprovar pjesërisht Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe është vendosur që lënda të kthehet në rigjykim pikërisht për shkak të kontestimit të përbërjes së trupit gjykues. Pastaj edhe në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese që në lidhje me këtë aspekt ka konstatuar shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], paragrafi 1, të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNj-së.

22. Për me tepër, në lidhje me paanshmérinë e gjyqtarit, në rastin *Fey kundër Austrisë* (24 shkurt 1993, parag. 30.), GjEDNj-ja ka theksuar: “*Edhe dukja e pavarësisë objektive mund të ketë rëndësinë e vet. Sepse ajo që është në rrezik ka të bëjë me besueshmérinë që duhet të nxisin gjykatat në një shoqëri demokratike në publik dhe mbi të gjitha për të pandehurin në çështjet penale.*” Nisur edhe nga ky konstatim, dhe për të ndikuar në rritjen e besueshmërisë së publikut në sistemin gjyqësor, Avokati i Popullit thekson se është e domosdoshme që lënda të kthehet në rigjykim në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, siç është vendosur fillimisht nga Gjykata Supreme me aktgjykimin e datës 11 qershori 2018.
23. Gjithashtu, duke ripërsëritur se e drejta e ankuesve për të rigjykuar lëndën ndaj tyre në Gjykatën Themelore, për shkak të kontestimit të përbërjes së trupit gjyques, është bërë në bazë të aprovimit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nga ana e Gjykatës Supreme dhe Aktgjykit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. ref 1248/18 bazuar në konstatimin për shkelje të nenit 31 [**E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm**], **paragrafit 1**, Avokati i Popullit thekson se kjo paraqet një standard të drejtë dhe ligjor edhe nga ana procedurale në lidhje me vlerësimin e paanshmërisë nga gjykatat. Kjo është në pajtim edhe me konstatimin tjetër të GjEDNj-së, që, në çështjen *Remli kundër Francës* (30 mars 1996), ka theksuar rëndësinë e ekzistimit të procedurave kombëtare për sigurimin e paanshmërisë, duke theksuar: “*Shkeljet e Nenit 6 kanë më shumë të ngjarë të ndodhin kur ato mekanizma mungojnë... dhe nëse një i pandehur ngre problemin e paanshmërisë, ajo duhet të hetohet ...*”

KONKLUZION


24. Nga kjo që u theksua me lart, Avokati i Popullit nxjerr përfundimin se Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykin PLM.KZZ.nr.223/2017 i GjS i dt. 11 qershori 2018, duke vendosur në bazë të Kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë së paraqitur nga avokati mbrojtës i z. Sylejman Selimit, e ka aprovuar si pjesërisht të mirë bazuar kërkesën sa i takon kontestimit të përbërjes së trupit gjyques të Gjykatës Themelore, dhe ka vendosur që lënda të kthehet në rigjykim në Gjykatën Themelore në Mitrovicë. Me këtë aktgjykim, z. Selimit i është dhënë një e drejtë gjyqësore procedurale që çështja kundër tij të rigjykohet, që do të garantonte standardin e gjykit të drejtë dhe të paanshëm të lëndës kundër tij.
25. Aktgjyki i lartpërmendur nuk është zbatuar, sepse, në ndërkohë, nga personat e tjerë, të bashkëpandehur (I. Th., Z. D., F. D., N. D., J. D., S. D., D. D., B. D. dhe A. D.) në lëndën që është e lidhur me çështjen kundër z. Selimit, kanë parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, e cila, me Aktgjykin e nr. AGJ 1248/18, i datës 7 qershori 2018, në lidhje me përbërjen e trupit gjyques, ka konstatuar se ka pasur shkelje “*të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe paragrafit 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*”, dhe çështjen e ka kthyer për rishqyrtim në Gjykatën Supreme. Pas kësaj, Gjykata Supreme, në zbatim të aktgjykit të Gjykatës Kushtetuese, ka nxjerrë **Aktgjykin Pml.nr.158/2018, datë 26.9.2018**, me të cilin ka refuzuar kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë për të gjithë ankuesit, duke përfshirë

edhe z. Selimin, edhe pse ky i fundit nuk kishte bërë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese. Si i tillë, ky aktgjykim (Pml.nr.158/2018, datë 26.9.2018) i cili ka keqësuar pozitën e z. Selimit në procedurë penale, duke ia mohuar një të drejtë të fituar (kthimin e lëndës në rigjykim në gjykatën themelore) bie në kundërshtim me aktgjykimin e muajit qershor 2018 (Aktgjykimin PLM.KZZ.nr.223/2017 të dt. 11 qershor 2018,) duke e “absorbuar” të njëjtin në lidhje me lëndën e z. Selimit. Kjo nënkuption se pa asnje shkresë apo pretendim të ri nga i pandehuri (z. Selimi), Gjykata Supreme ka refuzuar Kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të cilën me një aktgjykim paraprak e kishte aprovuar.

26. Mbi këtë bazë, konstatimi kryesor i Avokatit të Popullit në lidhje me çështjen penale ndaj ankuesve, është se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (**Pml.nr.158/2018, datë 26.09.2018**) është cenuar parimi i gjykimit të drejtë dhe të paanshëm. Mohimi i së drejtës gjyqësore të fituar me aktgjykimin paraprak të të njëjtës gjykatë bie në kundërshtim me Kushtetutën (nenin 31), me nenin 6 të KEDNJsë, me standardet e ndërtuara nga jurisprudanca e GjEDNjsë, si dhe me dispozitat e KPP-së në lidhje me arsyet për kthimin në rigjykim të çështjeve penale. Për me tepër, Avokati i Popullit vlerëson se kjo praktikë e Gjykatës Supreme ndikon negativisht në besimin e publikut për sistemin e drejtësisë penale në Republikën e Kosovës, dhe për besimin e vetë ankuesve në procedurë penale, se gjykimi i tyre ka qenë i drejtë dhe i paanshëm.
27. Avokati i Popullit vëren se Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Pml. 158/2018, të datës 29 shtator 2018, i dhënë në implementim të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. ref 1248/18, i datës 7 qershor 2018, nuk i ka përfillur në tërësi konstatimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës lidhur me gjetjet ligjore sa i përket arsyetimit të përbërjes së trupit gjykues (sipas paragrafëve 97, 98, 99, 100 dhe 101).
28. Po ashtu, Avokati i Popullit vëren se Gjykata Supreme, në Aktgjykimin PML. KZZ nr. 223/2017, për një rast të ngjashëm – identik me rastin në fjalë (rasti i z. Selimit), kishte aprovuar pjesërisht kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë në pjesën që ka të bëjë me pretendimet përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës Themelore, dhe lëndën e kishte kthyer për rigjykim në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.
29. Avokati i Popullit konstaton se Gjykata Supreme e Kosovës do duhej t'i merrte parasysh konstatimet e Gjykatës Kushtetuese, e po ashtu do duhej ta merrte parasysh edhe praktikën e vet gjyqësore, lidhur me rastin PML. KZZ nr. 223/2017, i dt. 11 qershor 2018, me të cilin kishte vendosur lidhur me përbërjen e trupit gjykues dhe kthimin në rigjykim të çështjes në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.
30. Me qëllim të evitimit të kësaj shkeljeje në raport me të drejtat gjyqësore të ankuesve, Avokati i Popullit, përmes këtij Mendimi Juridik (Amicus Curiae), kërkon nga Gjykata Kushtetuese, që, pas trajtimit të lëndës:

- TA SHPALLË TË PAVLEFSHËM Aktgjykimin Pml.nr.158/2018, datë 26.9.2018, sa i takon kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të z. Sylejman Selimit, Isni Thaçit, Zeqir Demakut. Fadil Demakut, Nexhat Demakut, Jahir Demakut, Selman Demajt, Driton Demajt, Bashkim Demajt dhe Agim Demajt.
- TA URDHEROJË Gjykatën Supreme që ta zbatojë Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. ref 1248/18, i datës 7 qershori 2018, dhe praktikës së saj, sipas rastit PML. KZZ nr. 223/2017, i dt. 11 qershori 2018.

Me nederime,


Hilmir Jashari
Avokat i Popullit